

## **ESKE**


Evaluation des compétences scolaires en langue première

### **Albanais**

Série de tâches de 5 à 6 ans d'expérience scolaire

**Detyrat**

1. Lexo tekstin me zë.

**Akrepi – një përfaqësues i familjes së merimangave**

Nuk do të ishte ide e mirë, që në vendet e nxehta të fusim gishtin në vrima të errëta, në mure ose në mes të gurëve. Është mirë gjithashtu që këpucët nëse një kohë të gjatë kanë qëndruar të hapura dhe të papërdorura, para se t'i mbathim t'i shkundim mirë. Sepse ekziston mundësia që diçka të jetë fshehur në këpucë. Akrepat nuk e pëlqejnë dritën; gjatë ditës me dëshirë fshihen nëpër vrima ose vende të errëta. Ata jetojnë në vende të ngrohta në gjithë botën, po ne rrallë herë i shohim ata.

**Ata e thumbojnë prenë (viktimën) e tyre për vdekje**

Akrepat mund të jenë shumë helmues, edhe pse shumica e llojeve për njeriun nuk janë vdekjeprurës. Ata varësisht nga lloji, mund të jenë ndërmjet një dhe njëzetentë centimetër të gjatë; por të gjitha llojet e kanë një thumb helmues në maje të bishtit. Kur akrepi e gjuan prenë e tij, e kapë atë me thonjtë e tij, e lakon lartë mbi shpinë bishtin e tij dhe e thumbon prenë e kapur. Një akrep frigacak rrotullohet shpejtë në mënyrë që thumbin e tij helmues ta drejtojë kah armiku i mundshëm.

Akrepat gjuajnë natën merimanga të mëdha dhe dëmtues (parazit) tjerë të vegjël. Ata së pari i prekin me kthetrat e tyre, e mbajnë shtrënguar prenë e tyre dhe pastaj e mbysin me thumbin helmues.

2. Lexo tekstin në detyrën numër 1 dhe shprehjet këtu poshtë. Kryqëzo nëse shprehja është e saktë apo e pasaktë.

1. Akrepat e dëshirojnë errësirën. E saktë   
E pasaktë
2. Të gjithë akrepat mund të i mbysin njerëzit. E saktë   
E pasaktë
3. Të gjithë akrepat janë njësoj të mëdhenj. E saktë   
E pasaktë
4. Akrepat e kapin prenë e tyre me kthetra. E saktë   
E pasaktë


3. Sqaro për çka bëhet fjalë në tekstin në detyrën numër 1.

4. Në tekstin e detyrës numër 1 thuhet se këpucët duhet me i shkundë. Përse duhet ta bëjmë këtë? Spjego përse mendon kështu.

5. Një garë nuk u mbajt për shkak të lagështisë. Rrumbullakëso tekstin përkatës.

- a) Gara me ambalazhe të qumështit duhej të nxitë një stil të shëndoshë jetese. Kushtet e vetme të pjesëmarrjes janë që automjeti të jetë i konstruktuar nga ambalazhi i kartonëve të qumështit, dhe ai të shtyhet me dorë dhe mbi ujë të mbërrijë në cak.
- 
- b) Gara me vaska mbahet qe 50 vite. Gara është e gjatë 58 kilometra dhe ka shumë rregulla të sigurisë. Të gjitha automjetet duhet të kenë madhësinë, formën dhe të përngjajnë në vaska të stilit të vjetër, si dhe motorri nuk duhet të jetë shumë i fortë.
- 
- c) Gara-Lumëthatë mbahet në një lumë të thatë. Një herë gara u anulua, sepse në lumë kishte ujë. Barkat në garë nuk kanë fund (patos) dhe duhet të tërhiqen nga pjesëmarrësit.
- 
- d) Gara me kanaqe të pijeve në ujë (kanotazhi) mbahet për çdo vit. Automjetet përbëhen prej kanaqeve të zbrazëta dhe janë të paisura me motor. Shumica prej tyre prishen që në fillim, çka e bën atmosferën shumë argëtuese (qesharake).

6. Shiko hartën dhe përgjigju në pyetje.



- a) Çka është më afër portit?
- Qyteti.
  - Liqeni.
  - Çifligu (ferma bujqësore).
- b) Cili vend është më në veri?
- Aeroporti.
  - Pylli.
  - Çifligu (ferma bujqësore).
- c) Nëse nga qyteti dëshiron të shkosh te liqeni, në cilin drejtim nisesh?
- Në drejtim të veriut.
  - Në drejtim të perëndimit.
  - Në drejtim të lindjes.
- d) Imagjino se je duke ecur në ishull. Përcjell udhëzimet:
- Fillo në fshat.
  - Mbaj rrugën në drejtim të portit.
  - Në udhëkryqin e dytë kthehu në të majtë.
  - Vazhdo deri në fund të rrugës.
  - Ku gjindesh tani?
- Tek çifligu (ferma bujqësore)
  - Në qytet.
  - Në port.

7. Lexo tekstin me zë.

### **Bushball**

Ke ndëgjuar ndonjëherë për lojën bushball? Në princip kjo lojë është një kryqëzim në mes të futbollit dhe golfit. Qëllimi i lojës është që me topin e futbollit të gjuhet drejt një flamuri të ngulur në një fushë; dhe, me sa më pak gjuajtje të qëllohet flamuri. Loja zhvillohet së paku me dy vetë, prej të cilëve njëri lojtar e ngul flamurin ndërsa të tjerët përpiqen që ta qëllojnë atë.

Numërohen vetëm gjuajtjet deri sa të qëllohet flamuri. Nuk bën të jenë më shumë se nëntë gjuajtje. Gjyroja (rundi) e parë kryhet kur secili lojtar njëherë ta ketë ngulur flamurin. Lojtarët vendosin vet se sa gjiro do të luhen.



8. Lexo tekstin në detyrën numër 7 dhe kryqëzo përgjegjjet e sakta.

a) Për çka bëhet fjalë në tekst?

- Teksti sqaron dallimet në mes të futbollit dhe golfit.
- Teksti i sqaron rregullat e lojës së Bushball-it.
- Teksti përshkruan një flamur të veçantë.
- Teksti e spjegon përse mund të përdoren flamujt.

b) Çka duhet të qëllohet (goditet) në bushball?

- Lojtari i cili e mban flamurin.
- Flamuri të cilin lojtari e mban në dorë.
- Flamuri i cili është i ngulur në tokë.
- Në mes të dy flamujve që janë të ngulur në tokë.

c) Çka numërohet?

- Numri i goditjeve në cak.
- Numri i gjirove.
- Lojtarët vendosin vetë.
- Numri i gjuajtjeve deri sa caku të goditet.

d) Për cilat lloje të sportit bëhet fjalë në bushball?

- Golf dhe tenis.
- Futboll dhe golf.
- Hendboll dhe futboll.
- Golf dhe hendboll.

e) Kur përfundon një gjiro? Kur të gjithë lojtarët nga njëherë...

- kanë ngulur flamurin.
- kanë goditur cakun.
- kanë gjuajtur topin.
- kanë goditur lojtaret e tjerë.

f) Çka do të thotë „një kryqëzim në mes të futbollit dhe golfit“?

- Loja luhet në një udhëkryq rrugor.
- Njëkohësisht luhet futboll dhe golf.
- Loja është nga pak si futboll dhe nga pak si golf.
- Njëri grup luan futboll dhe ndërsa në të njejtën kohë grupi tjetër luan golf.

